



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe konform nenit 15 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 26.02.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Ekoregjioni", me këtë përbërje:

1. Syl ZENELAJ-----i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar
2. Demokrat VATAJ-----i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar
3. Jehona RRAFSHI-LUMI -----e emëruar nga Kryetari Komunës-----anëtare

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr-02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-39/2008" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni 3

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekoregjioni" Sh.A, me seli në Suharekë.

3.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 410-9873
Me datë 27.02.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhët KUÇI